

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Marrëdhënia Turqi-Greqi - Sërish dallgë në Egje?
ADRESA	https://dosja.al/bota/marredhenia-turqi-greqi-serish-dallge-ne-egje-i516437
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 07:01:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 06:57:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	365f3e435b8d17dfdfd124c79a7eb9437a71f83dfde3cc1bc83ae5b465fa2736
TEKSTI	868491b7c0078a1733191d182047cef41a2e63253fdf05dc8770533e0540e19c
PAMJA	35b84c1022df21602280f9e6cfbe48963e94f8c28ce59a2fc88ca2c600419c76

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	843c04cc8440ebf2ddc87e140d6b5e3861b10fc81edd923a985e446e8151154e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c6e9ce599dcf050571ac11f5fe8a3879623b3af12e442f4fee76de6471dba328
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/843c04cc8440ebf2ddc87e140d6b5e3861b10fc81edd923a985e446e8151154e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

13 ORE ME PARE

120 ditë protestë/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, me thirrje e pankarta në duar: Rama jep dorëheqjen

17 ORE ME PARE

Kryeministri anuloi konferencën me gazetarët, Berisha: Kapitullim pa kushte i Ramës. Bardhi: Përgjegjësia nuk shmanget

18 ORE ME PARE

Rama sulmon mediat dhe Opozitën, mbron Vlora Hysenin por nuk e përmend Agasin: Masa ishte ekstreme, llogaria me drejtësinë është personale

1 DITE ME PARE

"Projekti i Sazanit dhe Zvërnecit, të jashtëzakonshëm për ekonominë shqiptare"/ Rama për protestën në SHBA: U ndjeva si në Tiranë, njëri kishte ardhur nga Britania për të më gjuajtur me vezë

Bota

Marrëdhënia Turqi-Greqi - Sërish dallgë në Egje?

Në fund të fundit, një të drejtë të tillë e parashikon Konventa e OKB-së për të Drejtën e Detit.



28 Shtator 2026, 08:57
Nga E.d



Foto ilustruese

Greqia dhe Turqia akuzojnë njëra-tjetrën se janë përgjegjëse për rritjen e tensioneve mes dy vendeve. Bëhet fjalë për ujërat territoriale, pretendimet e sovranitetit dhe ndikimin në rajonin e Mesdheut. Është një përshkallëzim i vazhdueshëm akuzash nga të dyja palët: Greqia ankohet për shkelje të hapësirës së saj ajrore nga Turqia, për zonat detare turke që, sipas saj, janë të paligjshme, si dhe për dislokimin e trupave turke pranë bregdetit. Nga ana tjetër qëndron presidenti turk Recep Tayyip Erdoğan, i cili i kërkon Greqisë t'i japë fund "militarizimit" të ishujve të saj. Ndërsa ministri i Jashtëm turk, Hakan Fidan, e cilëson këtë si një kërcënim për sigurinë e Turqisë.

Greqia po forcon armatimin

Meri Bossi, profesoreshë e nderuar e Sigurisë Ndërkombëtare në Universitetin e Pireut, paralajmëron për një epokë të re: "Po shohim një përshkallëzim në rritje dhe një retorikë kërcënuese si nga Turqia, ashtu edhe nga Greqia. E gjithë kjo, së bashku me mjedisin e pasigurt rajonal dhe ndërkombëtar, mund të bëjë që këto tensione të arrijnë në një pikë edhe më ekstreme."

Qeveria greke duket se po mbështetet te parandalimi përmes forcës ushtarake. Parimi është: kush dëshiron paqen, duhet të jetë i përgatitur për luftë. Në fund të gushtit, Greqia nënshkroi me Izraelin një kontratë armësh me vlerë miliarda euro, të quajtur "Mburoja e Akilit". Në kuadër të saj, Greqia do të pajiset me një sistem të avancuar të mbrojtjes ajrore, ndërsa njëkohësisht po investon edhe në industrinë e vet të mbrojtjes.

Pak vëmendje në Evropë për konfliktin

Sipas analistit dhe gazetarit grek John Psaropoulos, këto masa kanë të bëjnë vetëm me vetëmbrojtjen: "Nga këndvështrimi grek, destabilizimi i rajonit përreth Ukrainës dhe tani edhe në Gjirin Persik dhe Detin e Kuq është një lajm i keq për përpjekjet për të frenuar konfliktin me Turqinë."

Sipas tij, këto konflikte kanë krijuar "një atmosferë paligjshmërie", në të cilën lufta është normalizuar. Gazetari Psaropoulos ankohet se konflikti me Turqinë gjen pak vëmendje në Evropë dhe në Gjermani. Por sa më gjatë të mbeten konfliktet të pazgjidhura, aq më i madh është rreziku që në afatgjatë të lindin probleme serioze. "Greqia e sheh Turqinë si një Rusi të mundshme. Të njëjtin perceptim kërcënimi që Evropa ka sot ndaj Rusisë, Greqia e ka prej kohësh ndaj Turqisë", thotë ai.

editoriale

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Auron Janku

"Washingtonët" tanë

Në vëmendje

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 08:26

Analiza: Pse nuk flitet për viktimat e krimeve të luftës?

POLITIKE 28 SHTATOR 2026, 07:33

Arrestimi i Vlora Hysenit, mblidhet sot Këshilli i Sigurisë Kombëtare

AKTUALITET 28 SHTATOR 2026, 07:12

Protestat kundër qeverisë/ Gazeta gjermane: A do të jetë i rrezikshëm Revolucion i Flamingo për Edi Ramën?

Një perceptim që rrjedh nga historia e konfliktit që nga periudha osmane. Ronald Meinardus, i cili ka doktoruar mbi këtë temë, aktualisht bashkëpunëtor shkencor në institutin kërkimor athinas ELIAMEP shprehet, se "palët nuk bien dakord as për atë se çfarë është në të vërtetë objekt i mosmarrëveshjes, edhe as për mënyrën se si duhen zgjidhur këto çështje të debatueshme," thotë ai. Kjo, Sipas Meinardus, sjell që konflikti të mbetet në vendnumëro, pa ndonjë përparim drejt zgjidhjes.

Turqia kërkon të ndryshojë status quo-në

Për qeverinë greke, për shembull, çështja e zgjerimit të ujërave territoriale rreth ishujve të Egjeut deri në dymbëdhjetë milje detare konsiderohet e zgjidhur. Në fund të fundit, një të drejtë të tillë e parashikon Konventa e OKB-së për të Drejtën e Detit. Megjithatë, parlamenti turk ka vendosur që në vitin 1995 se, nëse Greqia e zbaton vërtet këtë hap, Turqia do ta konsiderojë atë si shkak për luftë.

Frika e Ankarasë është se, për shkak të numrit të madh të ishujve grekë, hapësira e ujërave ndërkombëtare në Detin Egje do të zvogëlohej ndjeshëm, duke kufizuar në mënyrë drastike lundrimin dhe qarkullimin detar turk.

Megjithatë, ka edhe shumë çështje të tjera mosmarrëveshjeje. Turqia, për shembull, flet për disa "zona gri", ku sovraniteti mbi disa ishuj dhe shkëmbinj të pabanuar, sipas saj, nuk është përcaktuar qartë. Nga këndvështrimi grek, statusi i këtyre territoreve është i rregulluar dhe i padiskutueshëm.

Vëzhguesi Ronald Meinardus sheh këtu një strategji të qëllimshme të Turqisë për të zgjeruar listën e çështjeve në konflikt. "Sa më e vogël të jetë shporta e mosmarrëveshjeve, aq më e vogël është mundësia të përfitosh diçka prej saj. Por sa më shumë çështje të hedhësh brenda, aq më e madhe është mundësia të nxjerrësh diçka në favorin tënd", përshkruan ai strategjinë turke.

Sipas Meinardus, status quo-ja aktuale është në interes të Greqisë. "Dhe pikërisht këtë status quo kërkon ta ndryshojë Turqia. Turqia është një fuqi revizioniste", thotë ai.

Politologu turk e sheh situatën si një "konflikt familjar"

Vëzhguesit grekë i referohen, për shembull, doktrinës turke të "Atdheut Blu" (Mavi Vatan), e cila pritet të diskutohet së shpejti në parlament. Ajo parashikon zgjerimin e ndjeshëm të zonave të ndikimit të Turqisë në Mesdhe. Kritikët e konsiderojnë këtë një projekt neo-osman me synime ekspansioniste.

Megjithatë, politologu Hüseyin Bağcı nga Ankaraja përpiqet të qetësojë situatën: "Mes Turqisë dhe Greqisë nuk mund të ketë një përplasje ushtarake, sepse të dyja vendet janë anëtare të NATO-s dhe nuk mund ta bëjnë një gjë të tillë. Ky është një konflikt familjar dhe duhet të zgjidhet brenda NATO-s, por edhe brenda Bashkimit Evropian."

Motive të politikës së brendshme?

Fakti që Turqia ka dërguar rreth 2.000 ushtarë në rajonin bregdetar në jug të Izmirit është, sipas vëzhguesve, një sinjal se Ankaraja është e gatshme të përdorë forcën ushtarake. Megjithatë, politologu Hüseyin Bağcı beson se presidenti Erdoğan nuk është i interesuar për një luftë.

Shumë zhvillime, bien dakord ekspertët, janë të motivuara nga politika e brendshme. Në pranverë mbahen zgjedhje në Greqi dhe kryeministri Kyriakos Mitsotakis nuk dëshiron të japë përshtypjen e një lideri të dobët. Një gjë është e sigurt: koha e "ujërave të qeta", siç u quajt periudha e relaksimit të marrëdhënieve pas vizitës së Erdoğanit në Athinë në vitin 2023, ka marrë fund./DW

- greqia
- turqia
- martdhenia

Sondazh

Poll

më të klikuarat

Rama sulmon 2 televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurori

Labirinti i errët i Edi Ramës

Shpresë për familjen Kotorri/ Emisioni italian publikon foton e ngjashme me Rajmonda Kotorrin që u zhduk 16 vjeçe në Itali

Çfarë po ndodh në Rinas? Rama lë gazetarët jashtë dhe anulon konferencën, video-mesazhi shpërndahet me regji nga Kryeministria

insights

Bledian Koka

Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by tomorrow.

Bota

28 Shtator 2020, 08:38

Bill Gates alarmon botën: IA mund të shkaktojë katastrofa me deri në 1 miliard viktima

Bill Gates SHBA- Miliarderi dhe bashkëthemeluesi i Microsoft, Bill Gates, ka dhënë një paralajmërim të fortë për rr...

Republika Çeke dhe objektivat e NATO-s

Bota

28 Shtator 2020, 08:21

VIDEO/ Moti ekstrem godet Indinë dhe Nepal, 68 persona humbin jetën

Bota

28 Shtator 2020, 08:16

VIDEO/ Tension i ri në Jemen, Huthitë raportojnë dhjetëra vdekje nga sulmet saudite dhe kërcënojnë me hakmarrje

Bota

28 Shtator 2020, 07:56

E djathta ekstreme po forcohet në Francë/ Partia e Le Pen fiton një grup parlamentar në Senat për herë të parë

Bota

28 Shtator 2020, 07:52

Bota

28 Shtator 2026, 07:43

Arrestohet Riccardo Bossi, djali i themeluesit të Legas dhe dënohet me 5 vite e 9 muaj burg

Riccardo Bossi ITALI- Riccardo Bossi, djali i madh i themeluesit të Lega-s, Umberto Bossi, është arrestuar në Busto Arsizio, në pr...

Konflikti në Lindjen e Mesme/
Hezbollahu: Izraeli dështoi të thyejë
rezistencën në Liban

Bota

27 Shtator 2026, 22:35

Venezuela liron të burgosur politikë,
opozita kërkon zgjedhje të lira

Bota

27 Shtator 2026, 22:23

Deklarata e Obamës për gratë në pushtet,
Trump: Mendoj se janë të
mrekullueshme, por kjo është qesharake

Bota


27 Shtator 2026, 22:00

Përkallëzohet përplasia Izrael-Turqi,
Netanyahu përgatit çështje kundër
Erdoganit në Hagë

Bota

27 Shtator 2026, 21:55

MË SHUMË



Mbledhja e Këshillit të
Sigurisë Kombëtare,
kryeministri Rama mbërrin
në Pallatin e Brigadave

Zjarr në Cjirokastër/ Merr
flakë makina, digjet edhe një
kasolle

Mbyllen fjalimet te
Kryeministria, nis marshimi i
protestuesve në rrugët e
Tiranës

Tragjedi në Fier/ Banesa



perishimet nga traket, humb
jetën 70-vjeçari i paralizuar

Mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare,
kryeministri Rama mbërrin në Pallatin e Brigadave



Shiko video te tjera



KTHEHU NE KRYE



Dosja.al është një iniciativë gazetareshe të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesi politik apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të të vërtetës.

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

Drejtor: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Emeralds Deal

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.